



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 73 Datë 26.03.2018

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO SETA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “SETA 1+2“, “SETA 3“  
DHE “SETA 4“.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2“ me fuqi të instaluar 7454 KW; “Seta 3“ me fuqi të instaluar 2722 KW dhe “Seta 4“ me fuqi të instaluar 4724 KW dhe me fuqi totale të instaluar 14900 KW,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. me shkresën nr. 165 Prot, datë 08.02.2018, ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 40, datë 23.02.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “SETA 1+2“, “SETA 3“ DHE “SETA 4“.
- Nga analiza e bërë dokumentacionit të paraqitur në këtë aplikim rezulton se, shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Hydro Seta” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Seta 1+2“ me fuqi të instaluar 7454 KW; “Seta 3“ me fuqi të instaluar 2722 KW dhe “Seta 4“ me fuqi të instaluar 4724 KW dhe me fuqi totale të instaluar 14900 KW, për një afat 30 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.